



Qyteti i fundit

Petro Marko

[Download now](#)

[Read Online](#) ➔

Qyteti i fundit

Petro Marko

Qyteti i fundit Petro Marko

Në këtë roman bëhet fjalë për fundin e ushtrisë pushtuese italiane në Shqipëri. Pas kapitullimit të fashizmit, në portin e Durrësit tubohen ushtarët e mbetur nga lufta dhe presin anijet nga Italia për t'u kthyer në vendin e tyre. Pikërisht gjatë ditëve të pritjes në këtë qytet të improvizuar buzë detit, shkrimtari Petro Marko do të zbulojë histori, drama, karaktere, psikologji të nxjerra nga njerëzit e qytetit të fundit. Përveç kësaj autori do të sjellë edhe rrëfimin për dashurinë e oficerit të ri shqiptar Lekës dhe prostitutës së bukur italiane Ana Maria Monte, viktimë po ashtu e luftës dhe e fashizmit.

Brenda 7 ditëve, aq sa qëndrojnë italianët e mbledhur në portin e Durrësit për t'u kthyer në Itali, shkrimtari në romanin "Qyteti i fundit" do të zbulojë dhe do të rrëfejë historitë dhe fatet e disave nga ushtria fashiste që para 4-5 viteve e kishte pushtuar Shqipërinë. Në këtë pleksje historish e fatesh, autori do të sajë linjën e rrëfimit që ndjek hetimi për zbulimin e një kriminelit luftë, të maskuar dhe të fshehur brenda turmës së "Qytetit". Në krye të grupit që duhet ta organizojë dhe ta udhëheqë këtë zbulim është toger Leka. Pista që ndjek togeri në këtë drejtim, e ngjashme me labirintet e romaneve dedektive, do të ecë dhe përmes prostitutës italiane - Ana Maria Monti. Dhe do të lindë dashuria mes tyre, që është shumëfish më "mëkatore" se ajo mes Gorit dhe Anitës. Leka është toger i Sigurimit Shtetëror të Shqipërisë së sapodalë nga lufta, që la pas shkatërrime dhe krime, ndërsa italiania Ana është e palës që i kreu ato krime, e palës së cilës i shërbente. Kështu shkrimtari, duke ndjekur këtë linjë do të ecë nëpër një teh të mprehtë: do ta lejojë togerin e Sigurimit t'i nënshtrohet zërit të brendshëm dhe të dashurohet me italianen e bukur, apo do të nxjerrë para tij fuqinë e përgjegjësisë dhe të mëkatit ndaj "mollës së ndaluar"? Romani "Qyteti i fundit", në këtë drejtim, sjell mjeshtrinë e të rrëfyerit të Petro Markos, që, i futur vetë mes dy zjarreve, arrin të manovrojë dhe t'u krijojë hapësirë artikulimi të dy krahëve, duke realizuar portrete komplekse, në radhë të parë si ai i toger Lekës. Gjithsesi ai si shkrimtar, pati i pari kurajo krijuese që të prekë sfera delikate, të rrezikshme të realitetit shqiptar të kohës, pasojat e të cilave i ndjeu gjithë jetën.

Qyteti i fundit Details

Date : Published 2000 by Shtëpia Botuese "Omsca"

ISBN : 9789992740385

Author : Petro Marko

Format : 374 pages

Genre : European Literature, Albanian Literature

 [Download Qyteti i fundit ...pdf](#)

 [Read Online Qyteti i fundit ...pdf](#)

Download and Read Free Online Qyteti i fundit Petro Marko

From Reader Review Qyteti i fundit for online ebook

Drilona says

Nisa per t'a lexuar nga mbresat e mira qe me pati lene "Nata e Ustikes", nuk u zhgenjeva aspak, por as nuk e lexova me aq deshire sa te parin. Situata tek "Qyteti i fundit" behet me politike, pasi rrefen pjese nga jeta e partizaneve e fillesat e shtetit komunist. Nje nga vecorite e stilit te Markos qe kujtoj tani qe nga gjimnazi eshte ne mos gaboj, dashuria internacionale.(?) 25-vjecarishoku (Toger) Leke Gurra(fund e krye komunist xP) dhe 22 vjecarja (ish vegël e fashisteve) Ana-Maria Monti, nje shqiptar dhe nje italiane jane personazhet qe perbejne linjen e dashurise dhe nga ana tjeter partizanet dhe italianet e mundur, linjen e luftes. Ashtu si ne romanet e Remarkut(me te cilin me ngjan shume Petro Marko) edhe ketu kemi nje fund te dhimbshem. Por pavaresisht fundit pesimist,romani percjell nota optimiste. Mire do ishte qe romanin t'a lexonin edhe italianet per te mesuar si u trajtuan nga ne ne vitet '40 dhe si na trajtuan ne vitet '90 xP. Nejse,i'u pelqejne romanet e Remarkut,i'u ka pelqyer "Nata e Ustikes",apo doni te lexoni disa vepra te mira shqiptare se i keni lene shume pas dore autoret shqiptare,atehere lexojeni "Qytetin e fundit". Ahh ne rast se beheni kurioz per titullin; romani titulloht keshtu per shkak se ne bregdetin e Durresit ishte improvizuar nje "qytet" ku italianet e fundit te mbetur ne Shqiperi priten per 7 dite me radhe vaporet e te papergjegjshmeve te UNRRA-s me te cilet do te ktheheshin ne atdhe.

Nikolin Kote says

e bukur , por e dhimbshme.

Enxhi Hasanaj says

Pas nje periudhe gati 2 vjecare vendosa ti rikthehem letersise shqipe, dhe nuk mund ta beja me mire se me Markon, nje nder te preferuarit e mi. Dhe si gjithmone, nuk me zhgenjehu! 'Qyteti i Fundit' eshte nje nder librat qe me kishte shpetuar pa shfletuar, dhe do e sugjeroja te kushdo qe dashuron fjalet shqip te qendisura ne nje nivel qe edhe shkrimtar te medhenj boterore do e kishin zili.

Stili i Petro Markos eshte e vertet qe ngjason me ate te Remark, por ama kur kalon neper situata qe ndoshta i ke degjuar nga historite qe te tregonte gjyshja dikur, gjithcka ndryshon. Arrin te prekesh nje Shqiperi tjeter nga mund te mesosh shume!

Historia e shkurter ne kohe (1 jave) por e ngjeshur ne situata, ngjarje, ndjenja, kujtime... te ben per vete faqe pas faqe! Nje lufte qe dermoi mijera vet, nje dashuri e nisur dhe e parealizuar, dashuri te tjera qe nje zot di si perfundojne, njerez qe skane me fuqi te jetojne... 2 popuj dhe pafund histori! Jane kaq shume gjera qe mund te zbuloni brenda ketij romani!

Regina says

...

Edma says

nje histori shume e arrire ;)
